



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 11/37  
Datë: 23.03.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 mars 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet Koncept Dokumenti për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besueshme në lidhje me Transaksionet Elektronike.
2. Obligohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**



Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*  
*Ministria e Zhvillimit Ekonomik*  
*Ministarstvo Ekonomskog Razvoja-Ministry of Economic Development*

---

**KONCEPT DOKUMENTI PËR IDENTIFIKIMIN ELEKTRONIK DHE  
SHËRBIMET E BESUESHME NË LIDHJE ME TRANSAKSIONET  
ELEKTRONIKE**

## **Kapitulli 1**

### ***Hyrje - (Dokumentet ndërlidhëse)***

Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE) ka si mision kryesor zhvillimin ekonomik, që njëherit është edhe ndër qëllimet dhe prioritetet kryesore të Qeverisë së Kosovës. Përdorimi i teknologjisë informative e komunikuese (TIK) është treguar mjet i fuqishëm për të adresuar aspekte të rëndësishme për zhvillim gjithëpërfshirës të shoqërisë dhe ekonomisë së një vendi. Ekonomia dixhitale sjell përfitime të qëndrueshme ekonomike dhe sociale të bazuara në shërbime moderne online dhe lidhje të shpejtë të internetit.

Krijimi i një mjedisi të besueshëm online i cili do të garantonte besueshmërinë e transaksioneve elektronike, konsiderohet parakusht i zhvillimit të ekonomisë dixhitale.

Përdorimi shumëdimensional i TIK dhe mundësitë e saj për adresimin e shumë aspekteve të rëndësishme për zhvillim gjithëpërfshirës të shoqërisë dhe të ekonomisë, e bëjnë këtë teknologji me rëndësi parësore për politikatat publike. Shërbimet që ofrohen nëpërmjet Internetit si dhe siguria për qasje në informacion, së bashku me sistemet informatike dhe infrastrukturën e zhvilluar të komunikimeve elektronike kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, rritjen e konkurrencës dhe konkurrueshmërisë së sektorëve të rëndësishëm të vendit.

*Dokumentet që ndërlidhen me konceptin për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besueshme në lidhje me transaksionet elektronike.*

**Strategjia Kombëtare për Zhvillim (2016-2021)** – Shtylla 4, Masa 30 parasheh që SKZH do të sigurojë koordinimin e akterëve të ndryshëm të sektorit të TIK në mënyrë që të sigurohet shtrirja dhe **përdorimi sa më i gjerë i teknologjisë informative në proceset e bizneseve, institucioneve publike dhe institucioneve arsimore.**

**Politikat e sektorit të Komunikimeve Elektronike – Axhenda Dixhitale për Kosovën 2013-2020**– në kuadër të Prioritetit 2: *Zhvillimi i përmbajtjeve dhe shërbimeve elektronike dhe promovimi i përdorimit të tyre*, ka paraparë edhe objektiven e tretë: *Promovimi i zhvillimit të e-biznesit, respektivisht “Krijimi i kushteve të favorshme për zhvillim të e-biznesit, dmth. shqyrtimi i dokumenteve ligjore dhe ofrimi i sigurisë ligjore që do të mund të rrishte besimin e konsumatorëve, zvogëlonte pengesat rregullative kombëtare dhe garantonte mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve”* – si detyrë.

**Plani Vjetor i Punës së Qeverisë së Kosovës për vitin 2017-** me këtë plan është përcaktuar hartimi i Koncept Dokumentit për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besueshme në



lidhje me transaksionet elektronike në afatin kohor deri në Dhjetor 2017, i cili është përfshirë edhe në listën e Koncept Dokumenteve për vitin 2017. Kjo praktikisht paraqet fillimin e procesit të transpozimit të Rregullores së BE-së “eIDAS”.

**Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim dhe Asociimit (PKZMSA) 2018-2020** – në kuadër Matricës për masat afatshkurta, MZHE ka paraparë që gjatë vitit 2018 të bëjë hartimin e “Ligjit për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besueshme për Transaksionet Elektronike”, që ka të bëjë me transpozimin e Rregullores së BE-së Nr. 910/2014 (ang. eIDAS Regulation).

## **Kapitulli 2**

### ***Përshkrimi i çështjes / Problemit kryesor***

Zhvillimi i shpejtë i TIK-ut, ka pasur ndikim të madh në të gjitha sferat e jetës. Zhvillimi i e-biznesit, e-tregtisë, e-shërbimeve, e-shëndetësisë, e-arsimit, e-kulturës, kanë pasë ndikim shumë të madh në jetën e njeriut në të gjitha vendet.

Në kuadër të analizave të bëra gjatë miratimit të Axfordës dixhitale për Evropën, Komisioni Evropian ka identifikuar këto mangësi kryesore: tregun dixhital të fragmentuar, mungesën e ndërveprimit dhe rritjen e krimit kibernetik, që konsiderohen si pengesat kryesore për funksionimin e ekonomisë dixhitale. Këto mangësi janë paraqitur si rezultat i zhvillimit të hovshëm të TIK-ut dhe koordinimit jo të mirë në mes vendeve të BE-së për unifikimin e standardeve të sigurisë, ekzistimit të divergjencave rreth metodave dhe mënyrave të bashkëpunimit dhe veprimeve të pakoordinuara. Këto kanë qenë pengesat kryesore për krijimin e besimit në shërbimet e ofruara përmes internetit dhe njohjen reciproke të identifikimit elektronik.

Me qëllim të zgjidhjes së këtyre mangësive dhe zhvillimit të një tregu unik dixhital evropian, është bërë e domosdoshme përkrahja e iniciativave për miratimin e një kornize të re ligjore për nënshkrimet elektronike, vulat elektronike, vulat kohore elektronike si dhe dokumentet elektronike. Gjithashtu, nevoja për nxjerrjen e një kornize të re ligjore, erdhi edhe si rezultat i mangësive të vërejtura gjatë implementimit të dispozitave të Direktivës për nënshkrimin elektronik (Direktiva 1999/93/EC), siç janë: detyrimet e papërcaktuara kombëtare për mbikëqyrje të ofruesve të shërbimeve, çështjet juridike, teknike dhe të interoperabilitetit ndërkufitar dhe mos përshtatja me teknologjitë e reja (të tilla si nënshkrimi përmes cloud-it, etj.).

Marrë në konsiderim mangësitë e lartcekura dhe kërkesat për një treg unik në gjithë Evropën, BE-ja miratoi Rregulloren Nr. 910/2014 për identifikimin elektronik dhe shërbimeve të besueshme për transaksione elektronike në tregun e brendshëm (që zakonisht i



referohemi si Rregullorja e eIDAS), që paraqet një kornizë të re ligjore për nënshkrimin elektronik, vulat, kohën e vulosjes dhe dokumentet elektronike.

Kjo Rregullore zëvendëson Direktivën Nr. 1999/93/EC për nënshkrimin elektronik, e cila deri më tani i ka trajtuar nënshkrimet elektronike, por që është dëshmuar se nuk ka paraqitur një kornizë të plotë sa i përket sigurisë, besueshmërisë dhe përdorimit të lehtë për transaksionet elektronike ndër-kufitare dhe ndër-sektoriale.

Edhe Qeveria e Kosovës, e vetëdijshme për rëndësinë dhe ndikimin shumë-dimensional të teknologjisë së informacionit e komunikimeve, ka definuar Axhendën e vet Dixhitale për periudhën 2013-2020<sup>1</sup>, e cila është miratuar në vitin 2013.

Axhenda Dixhitale ka adresuar çështjet e identifikuar si nga ana e kërkesës ashtu edhe nga ana e ofertës (ang. Demand and supply), duke stimuluar shtrirjen e rrjeteve të qasjes së gjeneratës së re (ang. Next Generation Access Networks).

Një ndër objektivat kryesore të këtij dokumenti strategjik është edhe: *Promovimi i zhvillimit të e-biznesit*, respektivisht “*Krijimi i kushteve të favorshme për zhvillim të e-biznesit, d.m.th. shqyrtimi i dokumenteve ligjore dhe ofrimi i sigurisë ligjore që do të mund të rriste besimin e konsumatorëve, zvogëlonte pengesat rregullative kombëtare dhe garantonte mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve*” – si detyra për arritjen e kësaj objektive.

Agjenda Dixhitale ka identifikuar nevojën për politika të reja për të krijuar kushte të favorshme për zhvillim të e-biznesit dhe ofrim të sigurisë ligjore për të rritur besueshmërinë e transaksioneve elektronike. Për këtë qëllim si politikë e re do të merret për bazë transpozimi i Rregullorës së eIDAS.

Nënshkrimi elektronik i adresuar në kapitujt XII-XIII të Ligjit Nr. 04/L-094 për Shërbimet e Shoqërisë Informatike, nuk i plotëson mjaftueshëm kërkesat për nënshkrimet e avancuara dhe nënshkrimet e kualifikuara të besueshme që duke i shtuar kësaj edhe mungesën e akteve tjera nënligjore si derivat nga ky ligj, e forcojnë arsyeshmërinë për nevojën e nxjerrjes së një ligji të ri.

Ligji i ri do të krijojë bazë juridike për mbrojtjen shërbimeve dhe garantimin e sigurisë gjatë transaksioneve elektronike nëpërmjet Internetit. Kjo bazë ligjore dokumentet në format elektronik i trajton në mënyrë të barabarte me dokumentet tradicionale në format të letrës. Qartësimi i pamjaftueshëm në klasifikimin e besueshmërisë së nënshkrimit elektronik dhe në garantimin e sigurimit të efektit ligjor për nënshkrimin elektronik, mund të konsiderohen si mangësi që kanë penguar rritjen e shtrirjes së transaksioneve elektronike dhe krijimin e shërbimeve të reja në Kosovë.

---

<sup>1</sup> Axhenda Dixhitale për Kosovën 2013-2020

Po ashtu, mungesa e besimit dhe veçanërisht ndjenja e pasigurisë juridike konsiderohen të kenë qenë dekurajuese për konsumatorët, bizneset dhe autoritetet publike që të kryejnë transaksione në formë elektronike dhe të ofrojnë shërbime të reja.

Ngecja në implementimin e dispozitave të këtij ligji dhe nxjerrjen e akteve përcjellëse nënligjore mund të justifikohet, marrë në konsiderim jo gatishmërinë dhe përgatitjen e pamjaftueshme të deritanishme të sektorëve përkatës për avancimin e shërbimeve përkatëse si dhe zbatimin e pamjaftueshëm të implementimit të ligjeve që ndërlidhen me mbrojtjen e e-shërbimeve dhe të të drejtave të përdoruesve.

Gjendja më e mire qëndron në sektorin bankar, ku pavarësisht të gjitha mangësive të cekura ka pasur avancim të shërbimeve që kanë të bëjnë me identifikimin elektronik dhe transaksionet elektronike në aspekt të shërbimit të e-banking.

### ***Politikat aktuale***

Të gjitha aktivitetet sa i përket shërbimeve të shoqërisë informatike rregullohen përmes Ligji nr. 04/1-094 për Shërbimet e Shoqërisë Informatike (GZ/ Nr.6, datë: 11 Prill 2012). Ligji për Shërbimet e Shoqërisë Informatike ka për qëllim krijimin e mundësive dhe rrethanave të favorshme për zhvillimin e tregtisë elektronike, përdorimin e transaksioneve elektronike dhe përdorimin e nënshkrimit elektronik si nga Qeveria, bizneset por edhe qytetarët. Gjithashtu, ky ligj ka për qëllim edhe zvogëlimin e problemeve potenciale të keqpërdorimeve gjatë transaksioneve elektronike si dhe adresimin e sigurisë së sistemeve informatike.

Ky ligj ka përcaktuar dokumentacionin në formë elektronike juridikisht të barabartë me dokumentacionin tradicional të paraqitur në format të letrës, për të lehtësuar shërbimet elektronike që përfshijnë, por që nuk kufizohen në shitblerje që bëjnë konsumatorët nëpërmjet Internetit (eTregtia), shërbimet elektronike bankare dhe ato financiare (ePagesa), ofrimin e shërbimeve qeveritare (eQeverisja), blerjen në formë elektronike nga ndërmarrjet (eProkurimi) dhe aplikimin e nënshkrimit elektronik.

**Ministria e Zhvillimit Ekonomik përmes Departamentit të Postë Telekomunikacionit dhe Teknologjisë Informative (“DPTTI”)** propozon, harton dhe siguron zbatimin e dokumenteve të politikave dhe të strategjive, të komunikimeve elektronike dhe të shoqërisë së informacionit. Po ashtu, ndër detyrat dhe përgjegjësit tjera, DPTTI për fushën e shoqërisë së informacionit përkrah teknologjinë informative dhe të inovacioneve, p.sh. tregtinë elektronike; përkrah qasjen në teknologji për të gjithë qytetarët e Kosovës; etj.

**Agjencia e Shoqërisë së Informacionit (ASHI)** - propozon dhe koordinon të gjitha politikat që ndërlidhen me teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit në institucionet e



Republikës së Kosovës; harton dhe siguron zbatimin e strategjisë së qeverisjes elektronike dhe të planit të veprimit përkatës;

**Banka Qendrore e Kosovës (BQK)** - objektivi primar i BQK-së është të nxisë dhe të mbajë një sistem financiar stabil, duke përfshirë një sistem të sigurt, të qëndrueshëm dhe efikas të pagesave. Promovimi i sistemeve të sigurta, të qëndrueshme dhe efikase të pagesave përbën një nga funksionet kryesore për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Në lidhje me sistemet e pagesave, është kompetente për “promovimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të sigurta, të qëndrueshme dhe efikase të pagesave, të kliringut dhe të shlyerjes së letrave me vlerë”.

**Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve Kosovare (ARBK)** – është agjencion në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, i cili është organi përgjegjës për regjistrimin e bizneseve dhe administrimin e sistemin të regjistrimit të bizneseve;

**Agjencia e Regjistrimit Civil** – është agjencion në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, i cili është përgjegjës për regjistrimin civil dhe administrimin e regjistrimit qendror civil dhe të bazës së të dhënave; udhëheq dhe mbikëqyr zbatimin e projekteve; nxit investimet në fushën e shoqërisë së informacionit; akumulimin, administrimin, përhapjen dhe ruajtjen e të dhënave – Qendra nacionale e të dhënave, siguron mbrojtjen e të dhënave personale në formë elektronike, në pajtim me legjislacionin në fuqi;

### ***Ligjet dhe aktet nënligjore***

**Ligji Nr. 04/L-094 për Shërbimet e Shoqërisë Informatike** – ka për qëllim të krijoj mundësi dhe rrethana të favorshme për zhvillimin e tregtisë elektronike, përdorimin e transaksioneve elektronike dhe përdorimin e nënshkrimit elektronik si nga Qeveria, bizneset por edhe qytetarët. Gjithashtu, ky ligj ka për qëllim edhe zvogëlimin e problemeve potenciale të keqpërdorimeve gjatë transaksioneve elektronike si dhe adresimin e sigurisë së sistemeve informatike. Nënshkrimi elektronik është adresuar në kapitujt XII-XIII të këtij ligj, por nuk është përcjellë me nxjerrjen e akteve tjera nënligjore eventuale, të cilat do ta plotësonin këtë ligj dhe do të avancojnë zbatimin e tij.

## ***Programi aktual***

Krijimi i platformave vendore të tregtisë elektronike, ID kartat e lëshuara kohëve të fundit, rritja e përdorimit të shërbimeve të e-banking janë hapa të rëndësishëm në zbatimin e Ligjit për Shërbimet e Shoqërisë Informatike (e-commerce, e-signature). Tregtia elektronike ndërkufitare, blerja e mallrave në internet, si dhe transaksionet tjera elektronike kanë trend rritës gjatë viteve të fundit. Bazuar në informatat nga Dogana e Kosovës, nga 12 mijë blerje online në vitin 2015, ky numër është rritur në mbi 200 mijë blerje online në vitin 2016. Rritja dhe zhvillimi i sistemit bankar në Kosovë, sipas një analize të kryer nga Doganat e Kosovës, ka një ndikim të drejtpërdrejtë në fluksin e blerjeve në internet. Përveç kësaj, tregje të mirënjohura si amazon.com që kohët e fundit e kanë vendosur Kosovën në listën e vendeve që mund të bëjnë porosi online, kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e blerjeve në internet.

MZHE në programin legjislativ për vitin 2018 ka parashikuar hartimin e ligjit i cili do të transpozojë Rregulloren eIDAS. Në këtë drejtim MZHE vitin e kaluar ka organizuar një punëtori, të mbështetur nga TAIEK, me qëllim të ofrimit të këshillave për transpozimin e Rregullosës për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besueshme për transaksionet elektronike (eIDAS) në legjislacionin kombëtar.

## ***Shpenzimet aktuale***

Kategoria e shpenzimeve	Shpenzimet faktike në vitin paraprak	Buxheti këtë vit	KASH për vitin e ardhshëm
Buxheti i Ministrisë: (sheno secilin lloj të shpenzimit)	-	-	-
Buxhetet tjera: (shëno secilin lloj të shpenzimit)	-	-	-
Financimi nga donatorët	-	-	-
Shpenzimet e drejtpërdrejta nga Ministria e Financave	-	-	-



### ***Vlerësimi plotësues i politikës aktuale***

Duke i konsideruar problemet e vazhdueshme me të cilat përballen palët gjatë transaksioneve elektronike për shkak të sigurisë së pamjaftueshme dhe mangësive ligjore për mbrojtjen e tyre është paraqitur nevoja për përgatitjen e këtij koncept dokumenti për transpozimin e Rregullores "e-IDAS" në legjislacionin tonë.

Transpozimi i rregullores së eIDAS në legjislacionin vendor ka për qëllim nxjerrjen dhe plotësimin e bazës ligjore për fushat që i trajton kjo rregullore dhe që janë pjesërisht të mbuluara nga legjislacioni ekzistues, si dhe përafrimin e plotë me legjislacionin e BE-së.

Përmes këtij koncept dokumenti synohet të bëhet paraqitja e gjendjes aktuale dhe problemeve ekzistuese të legjislacionit tonë; analizimi i përmbajtjes, problemeve të adresuara dhe mundësive për zgjidhje që ofron Rregullorja e eIDAS, qëllimi dhe objektivat, opsionet e mundshme për transpozimin e saj, analizimi i opsioneve dhe sugjerimi i opsionit të rekomanduar

Ministria e Zhvillimit Ekonomik si ministri përgjegjëse për sektorin e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimeve në nivel kombëtar në bazë të Rregullorës Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive ka përgjegjësi dhe kompetencë edhe hartimin dhe monitorimin e zbatimit të legjislacionit për sektorin e telekomunikacionit dhe të teknologjisë informative.

Hartimi dhe miratimi i këtij ligji del edhe si nevojë për përmbushje të obligimeve që rrjedhin nga MSA, për përafrimin e legjislacionit me kornizën legjislative të BE-së. Ky ligj do të jetë si plotësim i kuadrit ligjor ekzistues, nëpërmjet transpozimit të Rregullores Nr. 910/2014 për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besueshme për transaksionet elektronike (eIDAS).

### **Përvoja në shtetet tjera**

#### **Shtetet e BE-së**

Rregullorja e eIDAS (Rregullorja e BE No.910/2014) është e zbatueshme direkt nga të gjitha shtetet anëtare nga fakti se kjo është një rregullore dhe jo një direktivë. Ajo zëvendëson Direktivën 1999/93/EC, e cili kishte lënë hapësirë për keq-interpretim dhe e komplikonte vlefshmërinë dhe njohjen e nënshkrimit elektronik në mes të vendeve të ndryshme të BE-së, duke u bërë kështu pengesë për konsolidimin e një tregu unik (të vetëm) të brendshëm për tregtinë elektronike (e-Commerce).

Sipas Rregullores eIDAS, dispozitat për shërbimet e besueshme, nga 1 korriku 2016, zbatohen direkt në 28 shtetet anëtare të BE-së.

## **Shembulli i Shqipërisë**

### *Legjislacioni*

Shqipëria e ka transpozuar pjesërisht Rregulloren e eIDAS me Ligjin nr. 123/2016, datë 15.12.2016 (Fletorja Zyrtare, nr. 259, datë 6 janar 2017) përmes të cilit ka amendamentuar Ligjin nr. 107/2015, datë 1.10.2015 (Fletorja Zyrtare nr. 182, datë 21 tetor 2015).

Amandamenti i Ligjit nr. 107/2015 është bërë duke ju referuar rregullores së Parlamentit Evropian dhe Këshillit nr.910/2014 dhe ligjit finlandez nr.617/2009, për identifikimin e sigurt dhe nënshkrimet elektronike. Shkalla e përafrit me acquis të BE-së është vlerësuar të jetë e pjesshme.

Ky ligj e rregullon kuadrin e nevojshëm ligjor për identifikimin elektronik të sigurt, vulat elektronike, shërbimin e transmetimit elektronik dhe autentifikimin e faqeve të internetit në Republikën Shqipërisë, përmes të cilit synohet përmirësimi i cilësisë së shërbimeve në sektorin publik dhe privat dhe verifikimi i cilësisë së tyre nëpërmjet teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

## **Shembulli i Malit të Zi**

### *Legjislacioni*

Mali i Zi e ka transpozuar Rregulloren e eIDAS në Ligjin mbi Identifikimet elektronike dhe nënshkrimet elektronike ( Službeni list Crne Gore, numër 31/2017 ; datë 12.05.2017)

Me këtë ligj Mali i Zi i rregullon kushtet për shfrytëzimin e nënshkrimit elektronik, vulës elektronike, vulës kohore elektronike, shërbimeve të dërgesave elektronike me porosi të lëndëve juridike, të avokatisë, gjyqësisë dhe procedimeve tjera për autentifikimin e faqeve të internetit si sistemin për identifikimin elektronik dhe kushteve për njohjen e identifikimit elektronik të shteteve tjera.

## **Shembulli i Austrisë**

Në Austri, Rregullorja e eIDAS mbi shërbimet elektronike të identifikimit dhe besimit për transaksionet elektronike në tregun e brendshëm zbatohet përmes Ligjit mbi Nënshkrimin dhe Shërbimet e Besimit (SVG, Gazeta Federale Ligji nr. 50/2016) dhe përmes aktvendimeve të nxjerra në bazë të këtij ligji.



Organi mbikëqyrës në pajtim me nenin. 12 të Ligjit nr .50/2016, është Telekom-Control-Kommission (TKK) që i mbikëqyr të gjithë ofruesit e shërbimeve të besimit (TSPs) të themeluara në Austri. TSP-ve u kërkohet ti jenë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Rregulloren eIDAS. Pajtueshmëria me këto kërkesa vërtetohet nga TKK në bazë të Neneve 12 deri 15 të Ligjit nr. 50/2016; në këtë detyrë, TKK-ja ndihmohet nga Autoriteti Rregullator Austriak për Transmetim dhe Telekomunikacion (RTR).

RTR-së i është besuar përgjegjësia e mbajtjes së 'listës së besueshme' të përcaktuar në nenin 22 të Rregullores eIDAS (neni 14 paragrafi 1 i Ligjit nr. 50/2016). Lista e besueshme përmban informacion mbi të gjitha TSP-të e kualifikuara të themeluara në Austri dhe mbi shërbimet e besueshme të ofruara nga këto TSP. TSP-të e pa kualifikuara përfshihen në listë sipas kërkesës. RTR e bën listën e besueshme në dispozicion të publikut të interesuar në formë të lexueshme nga makina, veçanërisht në formatin XML bazuar në ETSI Standardin TS 119 612 V2.1.1.

Lista përditësohet pas çdo modifikimi dhe në çdo rast, çdo gjashtë muaj.

Lista e besueshme përfshin informacionin në lidhje me ofruesit e shërbimeve të kualifikuara të besueshme dhe shërbimet e kualifikuara të besueshme të ofruara prej tyre, në përputhje me dispozitat përkatëse të përcaktuara në Rregulloren e eIDAS.

Përdorimi ndërkuftar i nënshkrimit elektronik është lehtësuar përmes Vendimit të Komisionit 2009/767 / KE të datës 16 tetor 2009, i cili ka përcaktuar detyrimin për Shtetet Anëtare të krijojnë, mbajnë dhe publikojnë listat e besueshme me informacion në lidhje me ofruesit e shërbimeve të certifikimit që lëshojnë certifikata të kualifikuara publike në përputhje me Direktivën 1999/93 / EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 13 dhjetor 1999 mbi një kornizë të Komunitetit për nënshkrimet elektronike dhe të cilat mbikëqyren / akreditohen nga Shtetet Anëtare. Lista e tanishme e besueshme është vazhdim i listës së besueshme të krijuar me Vendimin 2009/767 / EC.

Për të vërtetuar të dhënat e verifikimit të vulave, të cilat korrespondojnë me të dhënat e gjenerimit të vulave të përdorura nga RTR për të nënshkruar listën e besueshme Austriake, RTR shfrytëzon një infrastrukturë të rëndësishme publike që bazohet në Politikën e Certifikimit të RTR dhe Deklaratën e Praktikës së Certifikimit; këto dokumente i referohen Deklaratës së praktikës së certifikimit të organit mbikëqyrës.

## Kapitulli 3

### Synimet dhe Objektivat

#### *Synimi*

Objektivat që synohen të arrihen janë rritja e sigurisë për transaksionet elektronike, duke siguruar një bazë të përbashkët për bashkëveprim të sigurt elektronik midis qytetarëve, bizneseve dhe autoriteteve publike, duke rritur efektivitetin e shërbimeve on-line publike dhe private dhe të tregtisë elektronike në Republikën e Kosovës. Krijimi i një mjedisi të besueshëm online duke garantuar besueshmërinë e transaksioneve elektronike, është një nga parakushtet e zhvillimit të ekonomisë dixhitale, prandaj edhe i zhvillimit ekonomik. Ekonomia dixhitale sjell përfitime të qëndrueshme ekonomike dhe sociale të bazuara në shërbime moderne online dhe lidhje të shpejtë të Internetit.

Kjo politikë ka për qëllim krijimin e kornizës ligjore për identifikimin elektronik, vulat elektronike, shërbimin e dorëzimit elektronik dhe autentifikimin e faqeve të internetit në Republikën e Kosovës.

#### *Objektivat*

Kjo politikë do të krijoj mundësitë për identifikimin elektronik të sigurt, autentikimin, qasje në shërbimet ndërkufitare online si dhe zbatimin e rregullave për funksionalizimin e një regjimi uniform për njohjen e ndërsjellë të identifikimit elektronik midis shteteve zbatuese të eIDAS.

Zbatimi i kësaj politike synon të arrijë këto qëllime:

- Njohjen reciproke të sistemeve të ndryshme të eIDs ndërmjet shteteve (skemat e identifikuara për identifikimin elektronik)
- Njohjen reciproke të kualitetit të shërbimeve të besueshme
- Sigurimin efektiv ndërkufitar gjatë ndërveprimit të shërbimeve
- Sigurimin e qasjes në shërbimet e besueshme për përdoruesit me aftësi të kufizuara
- Harmonizimin i mbikëqyrjes në nivel nacional dhe rajonal të kualitetit të ofruesve të shërbimeve të besueshme dhe shërbimeve të tyre, mbikëqyrjen më të lehtë për ofruesit e shërbimeve të besueshme (masat ad hoc)
- Krijimin e listave të besueshme (për kualitetin e shërbimeve të besueshme) dhe sipas shenjës së besimit të BE-së



- Rritjen e mbrojtjes së të dhënave dhe minimizimi i një sërë të dhënash personale nga ofruesit e shërbimeve
- Arritjen e fleksibilitetit dhe neutralitetit teknologjik përmes akteve ligjore.

Për arritjen e këtyre qëllimeve, parashihet plotësimi edhe i objektivave, si:

- Ndërtimi i besimit të publikut në sigurinë e transaksioneve dixhitale dhe inkurajimi i qytetarëve dhe bizneseve që sa më tepër t'i përdorin nënshkrimet elektronike , duke demonstruar avantazhin e tyre për individët dhe bizneset .
- Heqja e pengesave ekzistuese ndërkufitare të identifikimit elektronik ndërmjet shteteve përdoruese të eIDs për autentikim, të paktën për shërbimet publike, që është një prej objektivave kryesore të kësaj rregulloreje.

## **Kapitulli 4**

### **Opsionet:**

#### ***Opsioni 1: Opsioni status quo (asnjë ndryshim)***

Korniza aktuale ligjore në fushën e shoqërisë së informacionit, respektivisht Ligji Nr.04/L-094 për Shërbimet e Shoqërisë Informative dhe veçanërisht kapitujt XII-XIII që kanë të bëjnë me nënshkrimin elektronik nuk kanë gjetur zbatimin e dëshiruar kryesisht për shkak të pengesave objektive, si: tregu dixhital i fragmentuar, mungesa e ndërveprimit, rritja e krimit kibernetik, mungesa e besimit në shërbimet e ofruara përmes internetit dhe njohjet reciproke të identifikimit elektronik.

Prandaj ruajtja e kësaj gjendjeje, ligjit ekzistues, do të ruaj edhe ndikimin negativ të bizneset, institucionet dhe individët që potencialisht merren me transaksione elektronike dhe është humbje e mundësive për zhvillimin të ekonomisë dixhitale, konkurruese dhe të integruar.

Çdo vonesë në transpozimin e Rregullores së eIDAS do të krijoj pengesa për kompanitë, që të mendojnë dhe planifikojnë se cilat procese pune mund të zgjedhin, çfarë opsione të reja do të përdorin dhe çfarë modelesh të reja të biznesit të marrin në konsideratë, gjë që nënkupton humbjen e mundësive të reja të dixhitalizimit dhe rrezikun për ngecje të theksuara në treg.

Për më tepër ligji ekzistues ka qenë i bazuar në direktivat e mëparshme të BE-së, për nënshkrimin elektronik, e që gjithashtu kanë rezultuar si të dështuara për arritjen e shtrirjes dhe përdorimit të tyre në të gjithë Evropën, duke përfshirë edhe Kosovën.

Opsioni status quo njëherësh do të nënkuptonte edhe prolongim të harmonizimit të legjislacionit të Kosovës me atë të BE-së në kuadër të fushës së shoqërisë së informacionit.

### ***Opsioni 2: Ndryshimi i politikës ekzistuese – nxjerrja e Ligjit të ri për Identifikimin Elektronik***

Gjendja ekzistuese rekomandohet fuqishëm që të përmirësohet përmes nxjerrjes së “Ligjit për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besueshme në Lidhje me Transaksionet Elektronike” përmes të cilit do të vendosej korniza e nevojshme ligjore për identifikimin elektronik të sigurt, vulat elektronike, shërbimet e transmetimit elektronik dhe autentifikimin e faqeve të internetit në Republikën Kosovës. Ky ligj do të vlente për shërbimet e besueshme, në mënyrë të veçantë për transaksionet elektronike, si dhe për skemat e identifikimit elektronik.

Nxjerrja e një ligji të veçantë dhe gjithëpërfshirës, do ti përmbushte kërkesat aktuale për plotësimin e legjislacionit dhe njëkohësisht do t'i plotësonte mangësitë dhe të metat e paraqitura në ligjin ekzistues, si dhe do të ofronte një qasje e cila mbetet e hapur për risi.

Për hartimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji është përgjegjëse MZHE, kurse do të jetë i zbatueshëm për të gjitha palët (organet qeveritare, bizneset, individët dhe të gjithë personat fizik e juridik) që janë të përfshirë në mënyrë direkte apo indirekte në shërbimet e besueshme që kanë të bëjnë me transaksionet elektronike, si dhe për skemat e identifikimit elektronik. Ky ligj nuk do të obligohet të zbatohet për ofrimin e shërbimeve të besueshme të përdorura ekskluzivisht në sisteme të mbyllura, të cilat rrjedhin nga legjislacioni kombëtar apo marrëveshje ndërmjet një grupi të caktuar pjesëmarrësish.

Çka do të përmbante Ligji?

Ligji do të përmbajë të gjitha dispozitat e nevojshme që do të bëjnë të mundur transpozimin dhe adaptimin për kushtet e Kosovës të Rregullores së BE-së Nr.910/2014 për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besueshme në lidhje me transaksionet elektronike në tregun e brendshëm.

Këto përfshijnë definimin e pikave kryesore si në vijim:

- “Identifikimi Elektronik i sigurt”, ku do të përcaktohet se çfarë është identifikimi elektronik i sigurt, vlefshmëria ligjore e tij dhe subjektet që lëshojnë mjetet e sigurta për kryerjen e këtij identifikimi. Gjithashtu, do të specifikohen kërkesat për procedurat për një identifikim elektronik të sigurt dhe skema “teknologjike” në të cilën ai bazohet, si dhe do të rregullohen kushtet për identifikimin fillestar të mbajtësit të mjeteve të identifikimit elektronik të sigurt dhe përmbajtja e certifikatave elektronike, në të cilat mbështetet ky identifikim.



- “Shërbimet e Besueshme dhe Autoriteti përgjegjës”, ku do të përcaktohen subjektet mbi të cilët bie përgjegjësia dhe barra e provës, në rastet e dëmeve të shkaktuara ndaj çdo personi fizik apo personi juridik. Gjithashtu, do të përcaktohen autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e këtij projektligji, mënyra e kontrollit, regjistrimit dhe ndërprerjes së veprimtarisë së ofruesve të shërbimit të besueshëm të kualifikuar, nga autoriteti përgjegjës.
- “Ofruesit e shërbimit të besueshëm”, ku do të përcakton kushtet për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë të ofruesve të shërbimit të besueshëm të kualifikuar, procedurën e dhënies së statusit “i kualifikuar” ofruesve të shërbimeve të besueshme dhe produkteve që ato ofrojnë, masat e sigurisë që duhet të ndërmarrin këta ofrues shërbimi gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre dhe mënyrën e raportimit pranë autoritetit përgjegjës.
- “Vulat Elektronike”, ku do të përcakton çfarë është vula elektronike dhe vlefshmëria ligjore e saj, certifikatat elektronike në të cilat ato bazohen, kriteret dhe specifikimet teknike që duhet të përmbushin pajisjet të cilat krijojnë këto vula.
- “Shërbimi i transmetimit elektronik”, ku do të përcakton se çfarë është shërbimi i transmetimit elektronik (të të dhënave) dhe vlefshmërinë ligjore të tij. Gjithashtu, do të përcakton kriteret teknike të cilat duhet të plotësojë një shërbim transmetimi elektronik për t’u certifikuar si shërbim i kualifikuar i transmetimit elektronik.
- “Autentifikimi i faqeve te internetit”, ku do të përcaktohen kriteret dhe specifikimet teknike që duhet të përmbajë një certifikatë elektronike e lëshuar ndaj një serveri faqeje interneti. Certifikata për autentifikimin e faqeve të internetit bën të mundur identifikimin e subjektit i cili zotëron faqen e internetit në mënyrë që të garantohet identiteti i tij real dhe të shmangen mundësitë abuzive për mashtrime ndaj qytetareve apo bizneseve të cilat përdorin një shërbim on-line të ofruar nga një faqe interneti.
- “Përgjegjësia ligjore”, ku do të përcaktohet përgjegjësia ligjore dhe detyrimet që ofruesit e shërbimeve të besueshme kanë ndaj përdoruesve dhe personave të tretë, garancitë pasurore dhe financiare që ato duhet të përmbushin, si edhe detyrimet që burojnë nga ndërprerja e veprimtarisë së tyre. Gjithashtu, do të specifikohet organizmi i testimit i cili kryen konformitetin e standardeve teknike për ofruesit e shërbimit.
- “Masat administrative”, ku do të përcaktohen masat administrative që ndërmerr autoriteti ndaj ofruesve të shërbimeve të besueshme, në rastet e konstatimit të shkeljeve apo mospërmbushjes së detyrave të përcaktuara në këtë projektligj gjatë

ushtrimit të veprimtarisë së tyre, si edhe procedurat e ankimit ndaj vendimeve të autoritetit.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik përveç përfshirjes së akterëve kryesor nga palët e interesit (si: ARKEP, ATK-MF, BQK, ARBK-MTI, ARC-MPB, ASHI, etj.), në procesin e hartimit të projektligjit planifikon të shfrytëzojë edhe asistencët teknike të TAIEX-it, i cili është treguar si instrument shumë efikas gjatë hartimit të projektligjeve të fushës së komunikimeve elektronike dhe shoqërisë së informacionit në të kaluarën.

### ***Opsioni 3: Ndryshimi i çasjes ekzistuese të zbatimit***

Opsioni i tretë nuk mund të zbatohet sepse politika ekzistuese (Ligji ekzistues për shërbimet e shoqërisë informatike), tanimë nuk është i kohës dhe është dëshmuar si jo efektiv edhe në vetë shtetet e Bashkimit Evropian. Në praktikën e shteteve të BE-së janë aplikuar çasje të ndryshme për tejkalimin e pengesave, problemeve dhe paqartësive të shfaqura, që kanë ndikuar në mos funksionimin apo mos efikasitetin e aplikimit të nënshkrimit elektronik (e-signature) në transaksionet elektronike në tregun e brendshëm. Është paraqitur e domosdoshme nxjerrja e Rregullores së BE-së për eIDAS, për të tejkaluar pengesat e shfaqura. Prandaj, njëjtë edhe për Kosovën është i kotë dhe i pavlerë tentimi i ndryshimit të çasjes, sepse aplikimi i identifikimit elektronik dhe i shërbimeve të besueshme në lidhje me transaksionet elektronike ka vlerë vetëm nëse është në harmoni me Rregulloren e eIDAS dhe do të mund të aplikohet edhe për identifikim elektronik dhe shërbimet e besueshme sa i përket transaksioneve elektronike edhe në tregun e BE-së dhe më gjerë.

## ***Kapitulli 5***

### ***Përmbledhja e Opsioneve***

Në vijim paraqesim tabelën me opsionet e përmbledhura:

<b>Përmbledhja e opsioneve</b>			
<b>Karakteristikat kryesore</b>	<b>Opsioni 1</b>	<b>Opsioni 2</b>	<b>Opsioni 3</b>
<b><i>Karakteristikat kryesore të opsionit</i></b>	Status quo	Hartimi i Ligjit për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besueshme në lidhje me transaksionet	Ndryshimi i çasjes ekzistuese



		elektronike	
<i>Segmenti i popullsisë /sektori/rajoni i shënjestruar</i>	Të gjitha palët që janë të përfshirë në mënyrë direkt apo indirekte (organet qeveritare, bizneset, individët dhe të gjithë personat fizik e juridik), në shërbimet e besueshme që kanë të bëjnë me transaksionet elektronike, si dhe për skemat e identifikimit elektronik, në gjithë Kosovën.	Të gjitha palët që janë të përfshirë në mënyrë direkt apo indirekte (organet qeveritare, bizneset, individët dhe të gjithë personat fizik e juridik), në shërbimet e besueshme që kanë të bëjnë me transaksionet elektronike, si dhe për skemat e identifikimit elektronik, në gjithë Kosovën.	Të gjitha palët që janë të përfshirë në mënyrë direkt apo indirekte (organet qeveritare, bizneset, individët dhe të gjithë personat fizik e juridik), në shërbimet e besueshme që kanë të bëjnë me transaksionet elektronike, si dhe për skemat e identifikimit elektronik, në gjithë Kosovën.
<i>Karakteristikat e zbatimit - kush është përgjegjës - një resor i Qeverisë (cili), sektori privat, qytetarët</i>		MZHE, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik - i themeluar brenda MZHE, ofruesit e kualifikuar të shërbimit të besueshëm dhe organizmat e testimit dhe konfirmimit	
<i>Administrimi ose zbatimi i programit ose shërbimit</i>	N/A	MZHE, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik - i themeluar brenda MZHE.	N/A
<i>Ligjet, aktet nënligjore, ndryshimet dhe plotësimet e ligjeve ekzistuese si dhe zbatimi dhe dënimet</i>	Ligji Nr. 04/L-094 për Shërbimet e Shoqërisë Informatike;	Plotësimi i kornizës ligjore të Shoqërisë së Informacionit me "Ligjin për identifikimin elektronik dhe shërbimeve të besueshme në lidhje me	Ligji Nr. 04/L-094 për Shërbimet e Shoqërisë Informatike;

